



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____ 2022

"PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 9244, DATË 17.6.2004, "PËR MBROJTJEN E
TOKËS BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR"

Në ligjin nr. 9244 datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 14, shtohet një nen 14/a me këtë përmbajtje:

1. Ndalohet ndezja e zjarreve në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 deri 6 të këtij neni.
2. Ndalohet djegia e lëndës kashtë apo mbetjeve të tjera bujqësore, barërave, farrave apo shkurreve, që rrezikojnë përhapjen e zjarreve në toka bujqësore, pyje dhe kullota, gjatë periudhës nga 1 Prilli deri 30 Nëntor të çdo viti.
3. Për periudhën tjetër të vitit ky proces mund të kryhet vetëm pas:
 - a. marrjes së lejes nga njësi e qeverisjes vendore, ku specifikohen: emri i personit apo personave që marrin përsipet veprimin e djegies, vendndodhja e sipërfaqes që do të djegjet, datën dhe orën kur do bëhet djegia; pëlqimi me shkrim i pronarëve ose poseduesve të pronave në kufi me pronën ku do të kryhet djegia;

b. marrjes së lejes nga shërbimet e mbrojtjes civile, ku përshkruhen masat parandaluese që zjarri të mos dalë jashtë kontrollit, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

4. Djegia e tokave bujqësore, vreshtave, pemtoreve, shkurreve e ferrave, rezervuar pikës 3 të këtij neni, në çdo rast duhet të bëhet duke plotësuar kushtet e mëposhtme :

- nisë dhe të përfundojë gjatë orëve të ditës (nga ora 08:00 - 18.00);

5. Në çdo rast ndalohet ndezja e zjarreve:

a) në zona që shtrihen brenda territorit të zonave të mbrojtura, zonave turistike, pikave të kalimit kufitar apo zonave kufitare të Republikës së Shqipërisë;

b) në distancë më të afërt se 100 metra nga akset rrugore kombëtare;

c) në distancë më të afërt se 2000 metra nga sipërfaqet pyjore, plantacionet me drurë të ndryshëm dhe vreshtat;

ç) në distancë më të afërt se 1000 metra nga pikat e shitjes së karburanteve apo depoizat e tyre;

d) në distancë më të afërt se 2000 metra nga fshati më i afërt dhe së paku 2000 metra larg çdo tranese individuale;

dh) në ditë kur era fryn me shpejtësi mbi 20 km/orë, edhe nëse janë marrë lejet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;

e) në një sipërfaqe më të madhe se 1000 m² brenda një dite.

6. Pavarësisht parashikimeve të mësipërme, në raste përjashtimore lejohet djegia në tokat bujqësore kur shfaqet domosdoshmëria e mbajtjes nën kontroll të sëmundjeve ose faktorëve të tjerë dëmtoës, bazuar në urdhërin e posaçëm të autoritetit kompetent për marrjen e masave emergjente kundër fatkeqësive natyrore.

7. Rregulla të hollësishtëm për marrjen e masave parandaluese për përhapjen e zjarreve në tokat bujqësore caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Në nenin 28, pas pikës d) shtohet një pikë dh) me këtë përmbajtje:

dh) mposhtimi nga pronarët e tokës bujqësore dhe posedues të tjerë të ligjshëm, të kërkesave të nenit 14.0 të këtij ligji, në rastet kur veprimtaria nuk përbën veprën penale të shkatërrimit të tokës, sipas përcaktimeve të nenit 23 të këtij ligji

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve të nxjerrë aktin nënligjor të përcaktuar në pikën 7 të nenit 1 të këtij ligji.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

LINDITA NIKOLLA